



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/36


Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet nga mbledhjet: 29, 30, 31 dhe 33 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet procesverbali nga mbledhja korresponduese\eletronike: 32 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/36
Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen prioritetet e fazës së dytë për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA 2), të dakorduara me Komisionin Evropian dhe të lansuar nga Kryeministri dhe Komisioneri i Bashkimit Evropian për Politika të Fqinjësisë dhe Zgjerimit më 8 tetor 2020, në Prishtinë. Këto prioritete shërbejnë për zbatimin e obligimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit të koordinojë hartimin e një plani dyvjeçar të veprimit, për periudhën 1 janar 2021 - 31 dhjetor 2022, për zbatimin e prioritetëve të ERA 2, dhe ta dorëzojë atë për miratim në Qeveri brenda vitit 2020.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit që gjatë procesit të hartimit të Planit të Veprimit të kryejë edhe konsultime me Komisionin Evropian dhe Shoqërinë Civile.
4. Obligohen të gjitha institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshira në hartimin e këtij Plani që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që Plani i veprimit të jetë i ndërlidhur me të gjitha dokumentet relevante.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani për Zbatimin e Marrëveshjes për Normalizim Ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Marrëveshja e Uashingtonit, 4 shtator 2020).
2. Obligohen të gjitha institucionet dhe organet e përmendura në Plan, ta zbatojnë Planin në bashkëpunim të plotë me akterët relevantë për secilën pikë të Planit, si dhe të njëjtat obligohen që të raportojnë në Qeveri çdo tre muaj për zbatimin e këtyre pikave.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/36
Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Programi për Zvogëlimin e Barrës Administrative.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/36
Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohen procedurat e blerjes së veturave zyrtare nga ministrinë dhe agjencinë në varësi të tyre.
2. Obligohen të gjitha ministrinë dhe agjencinë në varësi të tyre të cilat janë në proces të tenderimit të blerjes së veturave t'i ndalojnë procedurat bazuar në Ligjin Nr. 04\L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që brenda një jave nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të hartoj dhe sjellë për aprovim një Plan për Inventarizimin e të gjitha veturave zyrtare dhe një Plan për Rishpërndarjen e veturave zyrtare sipas nevojave të institucioneve, të cilat miratohen nga Komisioni i themeluar me vendim të Ministrit të Punëve të Brendshme.
4. Obligohen të gjitha ministrinë dhe agjencinë në varësi të tyre për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/36
Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/110 i datës 26.02.2010.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/36
Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Grupet e Produkteve të cilat janë Subjekt i Mbikëqyrjes Inspektuese.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 17 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Statuti i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Statutin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 17 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Statuti i Universitetit Publik "Fehmi Agani" në Gjakovë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Statutin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/36
Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 17 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Statuti i Universitetit Publik të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Statutin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 17 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Statuti i Universitetit Publik "Isa Boletini" në Mitrovicë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Statutin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 167 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L - 065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Tarifat e Përgjithshme për Shfrytëzimin e Lëndës së Mbrojtur me rastin e Ritransmetimit.
2. Tarifa për kompensim bazohet për grupet e kanaleve televizive të ritransmetuara sipas kategorizimit si në vijim:
 - 2.1. Deri në 70 TV kanale - 0.30 euro për abonues;
 - 2.2. Nga 71 deri në 100 TV kanale - 0.35 euro për abonues;
 - 2.3. Nga 101 deri në 150 TV kanale - 0.40 euro për abonues;
 - 2.4. Mbi 151 TV kanale - 0.45 euro për abonues.
3. Obligohen të gjithë operatorët kabllorë dhe subjektet tjera që të bëjnë ritransmetimin e kanaleve televizive për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Tarifat e përgjithshme botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për tërheqjen e Projektligjit për Tokën Ndërtimore nga procedurat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Kërkesën nga pika 1. të këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:


V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/10, të datës 05 korrik 2020 dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 07/14, të datës 14 korrik 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/10, të datës 05 korrik 2020, ashtu që riformulohet si në vijim: "Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 1.999.910,00 € (një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dhjet euro e zero centë), nga kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, të Kodit të nën programit 11303 Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë bujqësore nga fatkeqësitë natyrore elementare në komunën e Istogut, komunën e Pejës, komunën e Vitisë, komunën e Kaçanikut, komunën e Vushtrrisë, komunën e Klinës, komunën e Rahovecit, komunën e Mitrovicës së Jugut, komunën e Prishtinës, komunën e Drenasit, komunën e Skenderajt, komunën e Prizrenit, komunën e Fushë Kosovës, komunën e Shtimes, komunën e Podujevës, komunën e Mamushës, komunën e Leposaviqit, komunën e Gjilanit, komunën e Suharekës, komunën e Dragashit dhe komunën e Kamenicës".
2. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/10, të datës 05 korrik 2020, ashtu që riformulohet si në vijim: "Mjetet financiare të ndara nga pika 1. e këtij vendimi në shumën prej 25% ndahen nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, të Kodit të Programit 11303 Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme".
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 07/14, i datës 14 korrik 2020.
4. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/36
Datë: 19.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet organizimi i punëtorive jashtë Republikës së Kosovës nga të gjitha Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe njësitë tjera brenda sistemit ministror të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me hartimin, punimin apo diskutimin e dokumenteve qeveritare përfshirë strategjitë, koncept dokumentet, projekt aktet normative, dokumentet planifikuese dhe të gjitha dokumentet e ngjashme.
2. Ndalohet pjesëmarrja e zyrtarëve publik të punësuar në Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe njësitë tjera brenda sistemit ministror të Qeverisë së Republikës së Kosovës në punëtoritë që organizohen jashtë Republikës së Kosovës nga donatorët organizatat tjera, që ndërlidhen me aktivitetet për hartimin, punimin apo diskutimin e dokumenteve qeveritare përfshirë strategjitë, koncept dokumentet, projekt aktet normative, dokumentet planifikuese dhe të gjitha dokumentet e ngjashme.
3. Kur konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme, aktivitetet e përmendura në pikën 1. dhe 2. të këtij vendimi, mund të organizohen brenda territorit të Republikës së Kosovës, pas autorizimit nga Zyrtaret Kryesor Administrativ të organizatave buxhetore dhe Zyrtarët Kryesor Administrativ të Agjencive Ekzekutive, pjesë e një organizate buxhetore.
4. Autorizohet Ministrija e Ministrisë së Financave që me vendim të veçantë të përcaktojë tarifën e shpenzimeve ditore (shpenzime të imta - para xhepi) për udhëtime brenda vendit dhe kriteret të nevojshme për zbatimin e tyre në organizimet brenda Republikës së Kosovës, sipas pikës 3. të këtij vendimi.
5. Rekomandohet që kufizimet e këtij vendimi të respektohet nga të gjitha organizatat buxhetore që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, pavarësisht nga statusi dhe organizimi i tyre.
6. Ftohen donatorët dhe organizatat tjera (të huaja dhe vendore) që të respektojnë dhe mirëkuptojnë kufizimin sipas këtij vendimi, dhe punëtoritë e specifikuar në paragrafin 1 të këtij vendimi t'i organizojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës.
7. Obligohen të gjitha Ministrinë, Agjencitë Ekzekutive dhe njësitë tjera brenda sistemit Ministror për zbatimin e këtij Vendimi.

8. Ky vendim shfuqizon vendimin Nr. 11/12, e datës 20.03.2008 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Amandamentimit për Marrëveshjen e Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime (BEI), për financimin e projektit "Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10".
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministres së Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes për Amandamentimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për Projektin "Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale faza (dalëse) VI", ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4. Paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e Anëtarëve të Komisionit për Dhënie të Provimit të Jurisprudencës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Enver Peci, Kryetar i Komisionit, pyetës i lëndës E drejta Penale dhe zëvendës anëtar i Komisionit z. Vaton Durguti;
 - 1.2. Z. Dastid Pallaska, Anëtar i Komisionit, pyetës i lëndës E drejta Civile (materiale dhe procedurale) dhe zëvendës anëtar Rafet Haxha;
 - 1.3. Z. Nebojsa Boricic, Anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta Tregtare dhe zëvendës anëtar Mahir Tutuli;
 - 1.4. Znj. Aferdita Bytyqi, Anëtar i komisionit, pyetëse e lëndës E drejta Kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut dhe zëvendës anëtar z. Çerim Fazliji;
 - 1.5. Z. Ilaz Ramajli, Anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E drejta e Punës dhe E drejta Administrative dhe zëvendës anëtare znj. Shqipe Qerimi.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Komisionin sipas pikës 1. të këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 9 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçë, neni 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 22 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 05/L-009 për ndryshim dhe plotësim, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh.A, në përbërje të:
 - 1.1. Z. Sylejman Hyseni - Drejtor, kryesues;
 - 1.2. Z. Shyqeri Sadiku - anëtar;
 - 1.3. Z. Esat Peci - anëtar;
 - 1.4. Z. Safet Sadiku - anëtar;
 - 1.5. Drejtor, Përfaqësuesi i Punëtorëve.
2. Emërimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi, bëhet pas skadimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i emëruar në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Trepça" Sh.A., shërben në cilësinë e Bordit të Drejtorëve, sipas rregullimit në nenin 43 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- NP Trepça Sh.A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 22 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Posta e Kosovës" Sh.A, në përbërje të:
 - 1.1. Z. Leonard Shabanaj - Drejtor, kryesues;
 - 1.2. Z. Fadil Aliu - anëtar;
 - 1.3. Znj. Elda Maloku - anëtare;
 - 1.4. Z. Ujkan Kameraj - anëtar.
2. Emërimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi, bëhet pas skadimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i emëruar në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Posta e Kosovës" Sh.A., shërben në cilësinë e Bordit të Drejtorëve, sipas rregullimit në nenin 43 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- NP Posta e Kosovës Sh.A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/36

Datë: 19.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 22 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Infrakos" Sh.A, në përbërje të:
 - 1.1. Z. Brahim Selimaj - Drejtor, kryesues;
 - 1.2. Z. Sead Thaqi - anëtar;
 - 1.3. Z. Avni Kajdomçaj - anëtar;
 - 1.4. Znj. Sanja Lazarevic - anëtare.
2. Emërimi sipas pikës 1. të këtij Vendimi, bëhet pas skadimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
3. Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i emëruar në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Infrakos" Sh.a., shërben në cilësinë e Bordit të Drejtorëve, sipas rregullimit në nenin 43 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- NPQ Infrakos Sh.A